



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.102/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P.“Albatros Company” Sh.p.k, me NRB: ... me adresë ..., përfaqësuar sipas autorizimit nga A.A avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Green BSN Kosova” Sh.p.k., me nr. biznesi: ..., nrf. ..., me adresë ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.928/2018 të datës 17.10.2018 të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 12.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Green BSN Kosova” Sh.p.k., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.928/2018 të datës 17.10.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në faturën nr. 2016312 e datës 20.05.2016, nr. 2017689 e datës 23.06.2017, nr. 2017663 e datës 04.10.2017 dhe nr. 2018068 e datës 05.12.2017, në shumë prej 568.00 euro.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Green BSN Kosova” sh.p.k., ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.928/2018 të datës 17.10.2018 të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.P.“Albatros Company” Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.928/2018 të datës 17.10.2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës: nr. 2016312 e datës 20.05.2016 me vlerë 250.00 euro, nr. 2017689 e datës 23.06.2017 me vlerë 59.00 euro, nr. 2017663 e datës 04.10.2017 me vlerë 200.00 euro, nr. 2018068 e datës 05.12.2017 me vlerë 59.00 euro, nr. 2017333 e datës 25.01.2017 në vlerë 200.00 euro dhe nr. 2017337 e datës 27.01.2017 me

vlerë 59.00 euro, në shuma të përgjithshëm prej 827.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore dhe gjitha këto pagesa të bëhen në llogarinë e kreditorit në bankë përkatëse.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se fatura e cila është bashkëngjitur si dokument i besueshëm, nuk plotëson kushtet e përcaktuara të një dokumenti të besueshëm sipas LPP-së, duke shtuar se ne si kompani kemi bashkëpunuar disa herë dhe në shumicën e rasteve nuk kemi mbetur borxh pasi që detyrimet i kemi kryer menjëherë kur edhe është kryer shërbimi, kreditorit në emër të shërbimeve për rastet të cilat nuk janë paguar menjëherë e që ka qenë në vitin 2017, borxhin e mbetur i është paguar me datën 02.06.2017 në shumë prej 200 euro dhe me datën 04.08.2017 po ashtu borxhin në shumë prej 200 euro. Prandaj shifet se në bazë të urdhëri për përbarim faktet e paraqitura nga kreditorit nuk janë të sakta, së pari për faktin se fatura e cituara nuk i kemi pranuar, gjë që shifet edhe vet në fatura të cilat nuk janë nënshkruara nga ana e jonë dhe së dyti vlerat e paraqitura në propozim e përbarimit po ashtu nuk përputhen me vlerat të cilat është kryer shërbimi, kjo vërehet në faturën nr.2017663 e datës 04.10.2017 e cila është e sajuar meqë në atë kohë ne fare nuk kemi pasur Dudin të dhënat mallrat e doganuara. Nga kjo që u tha debitori konsideron dhe thekson se kreditorit nuk i ka mbetur borxh në lartësinë e lejuar por borxhi i vërtet e të cilin e di edhe kreditorit është në lartësi prej 427,00 euro. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kundërshtimi i kreditorit dhe të anulohet urdhri i përbaruesit.

Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim, ku thekson se prapësimi i kreditorit është i pabazuar dhe kontradiktor, pasi që propozimi për përbarim është i bazuar nën nenin 29 të LPP-së. Prandaj rezulton se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se faturat nr.6 e datës 17.05.2016 i përmban të gjitha ato që cekën në dispozitiv e nenit 29 të LPP-së. Kreditori ka kryer punët në llogari të debitorit në relacionin Novisad-Prishtinë, me çka shihet nga përshkrimi i faturave, debitori ka pranuar faturën e lartëcekur, por të njëjtën nuk e ka kontestuar as për nga baza dhe lartësinë e shumës nga fatura, prandaj debitori ka të vetëm qëllim shtyrjen e përmbushjes së detyrimit nda kreditorit. Në fund debitori nuk e konteston borxhin në lartësi prej 427 euro, çka do të thotë se më këtë pranon se kreditori i ka kryer shërbimet e transportit dhe të agjendit doganor. Sa i përket faturës nr. 2017633 e datës 04.10.2017 është vetëm një gabim teknik në numaracionin e faturave, ku si dëshmi ofrojmë tabelën ku figurojnë të gjitha importet e debitorit dhe të cilat nën tërësi përputhen me vlerën sipas propozimit të përbarimit. Andaj i propozojmë gjykatës, që të

refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbete në fuqi urdhëri përbarimore P.nr.928 e datës 17.10.2018 dhe të kompensoj shpenzimet lidhur me hartimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 104.00 euro sipas TAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përbarimor P.nr.928/2018 të datës 17.10.2018, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës nr. 2016312 e datës 20.05.2016, nr. 2017689 e datës 23.06.2017, nr. 2017663 e datës 04.10.2017 dhe nr. 2018068 e datës 05.12.2017 për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata gjeti se nr. 2016312 e datës 20.05.2016, nr. 2017689 e datës 23.06.2017, nr. 2017663 e datës 04.10.2017 dhe nr. 2018068 e datës 05.12.2017, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se të njëjta janë dorëzuar tek debitori, pasi që të njëjta nuk janë të nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit, dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përbarim.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin e përbaruesit Privat P.nr.928/2018 të dt. 17.10.2018 për pjesën tjetër të detyrimit, për faktin se dokumenti i besueshëm – faturat në bazë të cilës është iniciuar propozimi për përbarim, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi Urdhri i Përbaruesit Privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në faturat nr. 2017333 e datës 25.01.2017 në vlerë 200.00 euro dhe nr. 2017337 e datës 27.01.2017 me vlerë 59.00 euro, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur fatura është bërë e arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Andaj bazuar në të lartcekurat dhe nenin 73 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe neni 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.102/22, datë 12.05.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.